



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

DATË/A:	27 SHKURT 2013
REFERENC-Ë:	__/2013
PËR/ZA/TO:	Veton FIRZI, Sekretar i Përgjithshëm në MKRS
NGA/OD/FROM:	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion i Agjencisë rreth kërkesës për qasjen në dosjet e kandidatëve për drejtor të teatrit kombëtar

I nderuar z. Sekretar,

Bazuar në shkresën tuaj për dhënien e mendimit për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (në vijim MKRS) të 2013/05/02, në të cilin nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejme ASHMDHP), kërkohet këshillë mbi qasje complete në dosjet e kandidatëve (CV, letrën e motivimit, dhe dokumente të tjera që kandidatëve u kërkohen të paraqesin për konkurs), të cilët kanë konkuruar për pozitën e drejtorit të Teatrit Kombëtar në Prishtinë, dhe nëse një kërkesë e tillë nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN), është në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Këshilli i Agjencisë, në mbledhjen e mbajtur më 22/02/2013, në bazë të nenit 29, pika 2, paragrafi 1, si dhe neni 38, paragrafit 1 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale miratoi këtë:

OPINION

Nuk lejohet qasja në dosjet complete të kandidatëve (CV, letër motivacioni, dhe dokumentet e tjera që kandidatëve u kërkohen për dorëzim) për vend të lirë pune për postin e drejtorit të Teatrit Kombëtar në Prishtinë. Mund të lejohet qasja në informata të caktuara të cilat kanë qenë të kërkuara në konkursin publik, si p.sh: emri, përgaditja profesionale, përvoja e punës, aftësitë e tjera siç janë ato kompjuterike, njohja e gjuhëve të huaja etj.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka kërkuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të paraqesë kërkesën origjinale të dërguar nga ana e BIRN-it, me të cilën është kërkuar qasja e plotë në dosjet e kandidatëve.

Duke vepruar në përputhje me parimet e përpunimit të të dhënave, përkatësisht të nenin 3, paragrafi 1 dhe paragrafi 3 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ku thuhet se të dhënat personale përpunohen në mënyrë të ligjshme pa e cënuar dinjitetin e subjektit të të dhënave dhe se të dhënat personale duhet të jenë adekuate, relevante dhe mos ta tejkalojnë qëllimin për të cilin janë grumbulluar ose përpunuar më tujtje, ne besojmë se kjo kërkesë është në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Të dhënat që gjenden në dosjet e përgjithshme të kandidatëve përmbajnë të dhëna personale të tepërta, si për shembull, numrin e telefonit, e-mail adresën, statusin martesor, adresën, numrin personal, konfirmimin nga gjykata që nuk ka pasur procedura penale ose kundërvajtëse kundër aplikantit, dhe se nuk ka dënime të mëparshme (të cilat i takojnë grupit të të dhënave personale të ndjeshme), për të cilat kur është në pyetje interesi publik, përpunimi i tyre mund të bëhet vetëm "në qoftë se përpunohen në përputhje me ligjin për arsye të interesit thelbësor publik" (neni 6, paragrafi 1, paragrafi 1.8 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale), dhe mund të konkludojmë se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me interes thelbësor publik.

Nga kjo mund të shihet se kërkesa e dërguar është në kundërshtim me nenin e cekur më lart, neni 3, paragrafët 1 dhe 2 si dhe neni 6, paragrafi 1, paragrafi 1.8 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe për këtë arsye japim një përgjigje negative për kërkesën e BIRN-it drejtuar Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Nga ana tjetër, në nenin 5 të paragrafit 1, nënparagrafi 1.5 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale thuhet: "përpunimi është i nevojshëm për kryerjen e një detyre me interes publik ...". Në bazë të kësaj mund të konkludohet se ekziston neni i ligjit, i cili thirret në përpunimin e të dhënave personale, kur është fjala për interesin publik. Me këtë mund të konkludohet se disa informata mbi kandidatët e cekur më lart mund të jepen BIRN-it, pikërisht për të respektuar nenin 5 të Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe mbrojmë parimisht përpunimin e tyre. Ne besojmë se këto të dhëna (emri, kualifikimet, përvojën e punës, aftësi të tjera të tilla si aftësitë kompjuterike, gjuhë të huaja, etj.) janë të mjaftueshme për të kënaqur interesat e publikut, dhe nuk janë të tepërta në arritjen qëllimit dhe nuk kompromitojnë dinjitetin e subjektit të të dhënave.

Duke pasur parasysh të gjitha që u thanë më përpara, Agjencia ka pasur një qëllim për të gjetur një ekuilibër në mes të mbrojtjes së të dhënave personale dhe interesit publik, dhe në bazë të kësaj, ka sjellë opinionin e cituar më lart.